



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:242412
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05608345

Në ankesën e

AC-I-23-0419

Paditësi

B O, nga Fushë Kosova.

Kundër

E paditura/Ankuesja

Autoriteti i Likuidimit i NSH "Tregu" Prishtinë (në likuidim), të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0229 të datës 11 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0229 të datës 11 korrik 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 11 prill 2014, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN104-0360 të datës 11 shkurt 2015, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, e kishte refuzuar kërkesën e tij për kompensimin e pagës së papaguar për periudhën nga 01 gusht deri 31 gusht 2014, në shumën prej 600.00 euro, me arsyetimin se marrëdhënia e punës ankuesit i është ndërprerë me datë 14 korrik 2014, në ditën kur NSH "Tregu" ka hyrë në likuidim, dhe në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, NSH-ja nuk ka asnjë detyrim lidhur me pagat që kërkohen për periudhën pas fillimit të procedurës së likuidimit. Në ankesë paditësi pohon se bazuar në një Marrëveshje me AKP-në për shërbime në likuidim Nr. 11135 të datës 02 shtator 2014, ai ka ofruar shërbime për Autoritetin e Likuidimit për periudhën nga data 01.08.2014 e deri me 31.08.2014. Në ankesë ai ka pohuar se ka kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit i NSH "Tregu" që të bëjë pagesën e pagës në bazë të Marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve për Autoritetin e Likuidimit në shumë prej 500 euro, për muajin gusht 2014, e cila kërkesë është refuzuar me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke dhënë arsyetim që pas fillimit të procedurës së likuidimit me 14 korrik 2014 NSH-ja nuk ka asnjë detyrim kundrejt parashtruesit të kërkesës. Paditësi me ankesë e ka dërguar një kopje të Marrëveshjes me AKP-në për shërbime në likuidimi Nr.11135 të datës 02.09.2014, njoftimin për likuidim, emailat zyrtare për komunikimet e kryera, një fletë dorëzim pranim për dorëzimin e veturës të NSH "Tregu", procesverbal, një certifikatë të numrit fiskal, dhe komunikime tjera lidhur me punën e kryer në Autoritetin e Likuidimit.

Me datë 24 prill 2023, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së. AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se me datë 14 korrik 2014 ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së, andaj të gjithë punëtorët janë njoftuar se Kontrata e tyre e punës në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, ndërpritet në mesnatën e datës së Vendimit të Bordit për fillimin e procedurës së likuidimit. AKP-ja pohon se efekti ligjor i ndërprerjes së marrëdhënies së punës është paraparë saktësisht me ligj. AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka më bazë të

kërkojë ndonjë pagë pas fillimit të procedurës së likuidimit dhe se NSH-ja nuk ka më asnjë detyrim ndaj paditësit.

Me datë 06 maj 2023, paditësi e ka pranuar mbrojtjen e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje të mëtejme.

Me datë 11 korrik 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-15-0229, e aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshojë vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e detyrojë të paditurën që paditësit t'ia paguajë një pagë për periudhën 01 gusht deri 31 gusht 2014, në shumë prej 500.00 euro, e cila do të përmbushet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me 14 korrik 2014, për shkak se NSH "Tregu" ka hyrë në likuidim, mirëpo paditësi kishte arritur një Marrëveshje me të paditurën Nr.11135 të datës 02.09.2014 për ofrimin e shërbimeve për Autoritetin e Likuidimit të kësaj NSH-je. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se NSH-ja i ka mbetur borxh për një pagë për periudhën e cekur në shumë prej 600.00 euro ndërsa paditësi me ankesë ka kërkuar shumën prej 500.00 euro, e cila i takon që ti kompensohet. Prandaj nga këto arsye është aprovuar ankesa e paditësit dhe është ndryshuar vendimi i Autoritetit të Likuidimit i cili nuk ka mbështetje në ligj.

Me datë 14 korrik 2023, AKP-ja (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-0229 të datës 11 korrik 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se gjetjet faktike të Gjykatës së Shkallës së I-rë janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit thekson se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat duhet të respektohen, afati i parë është afati për parashtrimin e kërkesave që është një afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit e i cili afat e bënë kërkesën të pranueshme dhe afati i dytë ka të bëjë me meritat e kërkesës e që në këtë rast ka të bëjë me afatin e parashkrimit i cili është 3 vjet në përputhje me nenin 361 të LMD-së. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka sjellë prova për ta mbështetur kërkesën e tij që do të ishte bazë për aprovimin e kërkesës. Tutje AKP-ja pohon se paditësi

ka dështuar të saktësojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja kërkon që të merren në konsideratë argumentet e ngritura nga Autoriteti i Likuidimit, dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, e të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar.

Me datë 24 gusht 2023, paditësi e ka pranuar ankesën e AKP-së së bashku me urdhrin për të dhënë përgjigje në ankesë, por i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së, refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së e ka refuzuar si të pa vlefshme, kërkesën e paditësit për kompensimin e pagës së papaguar për periudhën nga 01 gusht deri 31 gusht 2014, në shumën prej 600.00 euro, me arsyetimin se marrëdhënia e punës ankuesit në bazë të ligjit i është ndërprerë me datë 14 korrik 2014, në ditën kur NSH-ja "Tregu" në Prishtinë ka hyrë në likuidim, dhe në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, NSH-ja nuk ka asnjë detyrim lidhur me pagat që kërkohen për periudhën pas fillimit të procedurës së likuidimit.

Në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, "Në mesnatën e Datës së Vendimit për Likuidim prishen të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë."

Në këtë lëndë në bazë të shkresave të dosjes është e qartë se NSH "Tregu" në Prishtinë ka hyrë në likuidim me datë 14 korrik 2014. Kolegji i Apelit konstaton se në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së ndërprerja e marrëdhënies së punës për ankuesin ka ndodhë me datë 14 korrik 2014.

Në këtë rast nuk është kontestuese fakti se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me 14 korrik 2014. Mirëpo paditësi ka kërkuar pagë për periudhën prej 01 gusht deri 31 gusht 2014, duke u bazuar në Marrëveshjen e lidhur me AKP-në për ofrimin e shërbimeve në likuidim. Paditësi nuk ka kërkuar nga NSH-ja ndonjë pagë në bazë të marrëdhënies së punës, e cila tashmë është ndërprerë, mirëpo ai kërkon ti kompensohet puna e kryer në bazë të marrëveshjes në fjalë.

AKP-ja e ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin që nuk qëndron se NSH-ja nuk ka detyrim ndaj paditësit pas fillimit të procedurës së likuidimit. Në fakt detyrimi për pagesën e kësaj page lind në bazë të Marrëveshjes për shërbime në likuidim, gjë që paditësi pretendon se nuk është bërë pagesa e pagës për muajin gusht 2014, ndërsa e paditura këtë pretendim të paditësit nuk ka mund ta kundërshtojë me ndonjë provë konkrete materiale.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën e paditësit, e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e kishte detyruar të paditurën ti paguajë paditësit shumën e kërkuar me ankesë prej 500.00 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar nuk i referohet parashkrimit të kërkesës, siç më vonë deklarohet AKP-ja me mbrojtjen në ankesë. Meqë kjo nuk ishte arsye ligjore e refuzimit të kërkesës, Kolegji i Apelit nuk do të marrë qëndrim ligjor nëse ka apo jo parashkrim të kërkesës.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, Kolegji i Apelit e ka refuzuar ankesën e AKP-së si të pabazuar, dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
